



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:070137

Datë: 24.10.2019

Numri i dokumentit: 00600665

**P.nr.867/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Bute Ramosaj – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.H., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1510/18, të datës 04.12.2018, në seancën publike të shqyrtimit fillestar, të mbajtur me datë 14.10.2019, në prezencën e Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, të dëmtuarve F.M.1. dhe F.M.2. dhe R.M., të akuzuarit I.H. dhe mbrojtësit të tij av.N.D. nga Gjakova, **me datën 16.10.2019** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 24.10.2019 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**I.H.**, nga i ati F., e ëma Z., e gjinisë L., data e lindjes..., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, punon në Universitetin e P. si Financier, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me datën 23.09.2018, rreth orës 20:30 minuta, në aksin rrugor Gjakovë - Prishtinë, pikërisht në fshatin C., Komuna e Gjakovës, duke e drejtuar automjetin e tipit “Mercedes 270”, me targa të regjistrimit ..., ngjyrë e zezë metalike, rrezikon trafikun publik në përmasa të mëdha dhe jetën e të ndjerës – vajzës së tij E.H., ashtu që duke shkelur nenin 53 lidhur me nenin 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.05/L-088, vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vije deri tek pasoja, lehtas e ka marrë se gjerë tek ajo nuk do të vije apo në momentin e duhur do ti shmanget, por pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që me të arritur në fshatin C., Komuna e Gjakovës nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes se automjetit të tij sipas kushteve dhe rrethanave të rrugës, i njëjti lëshon shiritin e tij të rrugës të anës së djathtë të drejtimit të tij dhe kalon në shiritin e majtë në drejtim të kundërt, ku si pasojë e kësaj me pjesën ballore të anës së majte e godet në pjesën e përparme të krahut të majtë automjetin e tipit “Ford Eas” me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të bardhë të cilën e drejtonte G.M., i cili në momentin kritik ishte në përballe kalim dhe si pasojë e inercionit del nga rruga dhe përplaslet me një kanal të ujit, me

ç'rast pasagjerja E.H. ndërron jetë në vend, ndërsa pas dëmeve materiale në veturë, lëndime trupore pësojnë edhe pasagjerët tjerë E.H., A.H., Gj.K. dhe vet i akuzuari, po ashtu lëndime trupore pësojnë edhe i dëmtuari G.M. dhe pasagjerët e tij F.M.1., L.M., F.M.2. dhe A. M. të cekura më hollësisht në akt-ekspertizën mjeko-ligjore të dr. V.H.i të dt. 19.11.2018.

Me këto veprime ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 23, 77, 78 par.1 nënpar 1.1 dhe nenit 378 par.9 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

## L I R O N N G A D Ë N I M I

Për shkak se pasojat e veprës penale e godasin kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Të dëmtuarit: R.M., A.(I.)H., E.(I.)H., që të gjithë nga Komuna e Gjakovës, Gj. (N.) K., Komuna e Pejës, G.(F.)M., F.(H.)M., F.(Rr.)M. dhe L.(R.)O., A.(G.)M. që të gjithë nga Komuna e Rahovecit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

**Detyrohet** i akuzuari I.H., që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88 Euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 50 Euro, shpenzimet e paushallit gjyqësor shumë prej 100 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1510/18, të datës 04.12.2018, kundër të akuzuarit I.H. nga Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit I.H., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari I.H., gjatë shqyrtimit fillestar pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av.N.D., ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se kërkon falje për këtë rast ngase në këtë rast ka humbur jetën edhe vajza ime.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 të KPRK-së, gjithashtu faktin se pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, e i cili pranim ka mbështetje të plotë edhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ti vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 73 dhe 74 i KPRK-së.

I dëmtuari F.M.2., duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, ndërsa si i dëmtuar deklaroi se parashtrori kërkesë pasurore juridike, meqenëse ende nuk jam kompensuar për dëmin që me është shkaktuar në këtë aksident, ngase kam pasur të lënduar krahun dhe brinjët dhe për shkak të gjendjes ekonomike kam pasur që të operohem por ende nuk jam kompensuar për dëmin.

E dëmtuara F.M.1., duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, për shkak se me dëshirë askush nuk e benë këtë punë, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike, parashtrori kërkesë për shkak se ende nuk jam kompensuar për dëmin.

E dëmtuara R.M.-Përfaqësuese ligjore e të ndjerës E.H. – nëna e saj, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, sa i përket ndjekjes penale, kërkoi që i njëjti mos të dënohet për shkak se në këtë rast bashkërisht kemi humbur e vajzën tonë, prandaj nuk kërkoj që të dënohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.H., av. N.D., duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: as mbrojtja nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, për shkak se i akuzuari është njoftuar me të gjitha shkresat e lëndës, pranimi i fajësisë është bërë në përputhje të kërkesave ligjore dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë. Po ashtu pajtohem edhe me deklarimet e prokurorit të shtetit që me rastin e caktimit të llojit të dënimit, gjykata të ketë parasysh rrethanat lehtësuese të akuzuarit, andaj kërkoj nga Gjykata pavarësisht se çfarë dënimi do të merr të ketë parasysh rrethanën se në rastin konkret ka humbur fëmijën i akuzuari dhe këto situata janë të rregulluara edhe me ligj, ku parashihet se mund të lirohet edhe nga dënimi ngase qëllimi i dënimit në rastin konkret konsiderohet se nuk mund të arrihet.

## 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari I.H., ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.N.D., pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari I.H., nga pakujdesia e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 4. Elementet e veprave penale

Në nenin 378 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik e kryen: “*Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror*”. Në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar forma e lehtë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston “*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia*”. Ndërsa në paragrafin 9 të këtij neni është parashikuar pasoja me e rëndë e kësaj vepre penale “*Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet*”.

#### 5. Vendimi për shpalljen fajtor të akuzuarit

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale ndërsa në bazë të ligjit ta lirojë nga dënimi, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e lirimit nga dënimi

Me rastin e vendosjes lidhur me vendimin mbi dënimin gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat, kështu që duke u mbështetur në nenet 77 dhe 78 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së ka gjetur se ekzistojnë bazat e posaçme të lirimit nga dënimi për veprën penale të kryer nga pakujdesia pasi që pasojat e veprës penale aq rëndë e godasin kryerësin sa që nuk ka kuptim të dënohet nga aspekti humanitar duke pasur kujdes për personin i cili edhe pse me fajin e tij, aq rëndë ka pësuar nga vepra penale, ashtu që vuajtjet e tija personale e tejkalon rëndësinë e dënimit, prandaj dënimi si e tillë paraqitet si i panevojshëm sepse në rastin konkret si rezultat i veprës penale ka humbur jetën vajza e tij e ndjera E.H. e moshës 7 (shtatë) vjeçare, si dhe lëndime kanë pësuar edhe dy vajzat e tjera të tij E.H., A.H. si dhe bashkudhëtari Gj.K.. Se me të vërtet vepra penale e ka goditur aq shumë të akuzuarin gjykata e vërtetoj edhe nga fakti se i akuzuari gjatë tërë seancës së shqyrtimit fillestar ka qenë emocionalisht i prekur thellë. Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh edhe për preventivën e përgjithshme dhe se vepra penale është kryer nga pakujdesia, prandaj është ardhur në përfundim se dënimi paraqitet si i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij nga neni 41 të KPRK-së.

#### 7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa

për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.867/18, me datë 16.10.2019**

**Procesmbajtësja,**  
**Bute Ramosaj**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.